



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot. 01-4105/14
Br. Prot. 01-4105/14
Prot. No. 01-4105/14
Data 12.11.2014
Datum 12.11.2014
Proj. stranica 03
Nr. pages 03
PRISHTINE

DATE/A:	11/11/2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Sabit SADIKAJ Drejtor i Departamentit të Prokurimit – Ministria e Drejtësisë
CC:	z. Eset RAMA Sekretar i përgjithshëm – Ministria e Drejtësisë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: "Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë (MD, SHKK, AAPSK)"



I nderuar z. SADIKAJ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë (MD, SHKK, AAPSK) " me nr. të prokurimit: 21500/14/001/221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me tenderin me titull: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë (MD, SHKK, AAPSK)" me nr. të prokurimit: 21500/14/001/221, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Drejtësisë.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues Ministria e Drejtësisë, bazuar në nevojën e sajë për Servisimin e Automjeteve, ka paraparë aktivitetet prokurimi me *Procedurë të Hapur*. Autoriteti Kontraktues ka përgatitë *Njoftimin për Kontratë me titull: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve të Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë (MD, SHKK, AAPSK)*" me nr. të prokurimit: 21500/14/001/221, e cila është publikuar më datë 28/08/2014 në faqen elektronike të Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP. Kjo procedurë në vetvete përmban tenderin të ndarë në tre LOTE: Në LOT 1 është paraparë: *Servisimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve - Mitsubishi, Toyota, Nisan, Hunday etj*; në LOT 2 është paraparë: *Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve – Reno Megan dhe Reno Master*; në LOT 3 është paraparë: *Servisimi dhe mirëmbajtja e Automjeteve – Audi A8, Shkoda Yet*.

Ky aktivitet Prokurimi me përmbajtje të ngjashme është iniciuar disa herë dhe nuk ka mundë të finalizohet. Tre herë është zhvilluar aktiviteti nga Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës–SHKK, dhe mbi pesë herë nga zyra e Prokurimit të Ministrisë së Drejtësisë. *Kronologjia e aktiviteteve të prokurimit sipas publikimit nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik – KRPP, e iniciuar nga SHKK është: Njoftim Kontrate më 05/09/2013, ka pasur Njoftim Anulimi më datë 09/10/2013. Asnjëri nga shtatë Operatorët Ekonomik nuk ka qenë i përgjegjshëm; Njoftim Kontrate më 16/10/2013, ka pasur Njoftim Anulimi më datë 24/10/2013. Arsyetimi i Anulimit ka qenë: Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit; Njoftim Kontrate më 04/11/2013, ka pasur Njoftim Anulimi më datë 16/12/2013, asnjëri nga tetë Operatorët Ekonomik nuk ka qenë i përgjegjshëm. Bazuar në Raportin e Vlerësimit të datës 11/12/2013, të gjithë Operatorët Ekonomik janë cilësuar si të pa përgjegjshëm sipas rubrikës “Çmimet duhet të jenë reale të tregut. Çdo çmim jo real dhe çmime spekulative ofertën tuaj e bënë të pa përgjegjshme”.*

Për aktivitetet e iniciuara nga Zyra e Prokurimit e Ministrisë së Drejtësisë, janë: Njoftim Kontrate më 30/01/2014, ka pasur Njoftim Anulimi më datë 03/02/2014. Arsyetimi i Anulimit ka qenë: Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit; Njoftim Kontrate më 04/02/2014, ka pasur Njoftim për Dhënie të Kontratës më 11/04/2014 për Lot.1 dhe Lot.2. Njoftim Anulimi për Lot.3 më datë 22/04/2014, arsyetimi ishte më pak se dy oferta të përgjegjshme; Njoftim për Dhënie të Kontratës të datës 11/04/2014) për Lot.1 dhe Lot.2 ka pasur Ankesë nga Operatorët Ekonomik në OSHP. Me vendim të OSHP-së, Anulohet Njoftim për Dhënien e Kontratës për Lot.1 dhe Lot.2. Arsyetimi i vendimit ishte “**çmimet jo normalisht të ulëta**”. Autoriteti Kontraktues e Njofton Panelin Shqyrtues të OSHP-së se do të përmirësoj dosjen dhe do ta ri tenderoj këtë aktivitet.

Njoftim Kontrate të datës 04/06/2014, aktiviteti është anuluar me Njoftim Anulimi të datës 10/07/2014, arsyetimi ishte më pak se dy oferta të përgjegjshme;

Njoftim Kontrate të datës 18/07/2014, aktiviteti është anuluar me Njoftim Anulimi të datës 14/08/2014. Arsyetimi më pak se dy oferta të përgjegjshme.

Kontrate të datës 27/08/2014 dhe Njoftim Kontrate 28/08/2014, aktiviteti është në proces. Agjencia Kundër Korrupsion ka monitoruar aktivitetin e fundit të këtij tenderi dhe ka ardhur në konstatim se procesi ka qenë kryesisht i rregullt. Operatorët Ekonomik kanë ofertuar me çmime shumë kontroversë. Autoriteti Kontraktues gjatë procesit ka konstatuar se çmimet e ulëta nuk e dëmtojnë buxhetin, krahas atyre çmimeve të larta. Autoriteti Kontraktues, Ministria e Drejtësisë më datë 08/10/2014/06-3667 ka bërë Kërkesë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në lidhje me çmimet jo reale të ofertave. Autoriteti Kontraktues përmes komunikimit na ka informuar se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk e ka përbërjen e plotë të Bordit, dhe përgjigja do të prolongohet.

Në aktivitetin e fundit të tenderit, kanë ofertuar pesë Operator Ekonomik, Për Lot.1 kanë ofertuar katër Operator Ekonomik; për Lot.2 kanë ofertuar tre, ndërsa për Lot.3 kanë aplikuar vetëm dy.

Ky aktivitet prokurimi, i shpallur më 28/08/2014 është vlerësuar dy herë nga Autoriteti Kontraktues. Herën e parë më 12/09/2014, ndërsa herën e dytë më 04/11/2014. Zyra e prokurimit kishte vendosur ta kthej në ri vlerësim për shkak të një formulimi në Dosjen e Tenderit, tek pika 9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkohej: *Lista me minimum 5 persona të angazhuar në servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve (personat që posedon operatori ekonomik-Lista me emër mbiemër dhe përgatitja përkatëse profesionale të atij stafi)*. Hamendja në komisionin e parë të vlerësimit ishte nëse lista duhet të përcillet me dëshmi tjera plotësuese (certifikata ose diploma) ose vetëm lista si dëshmi. Komisioni që kishte vlerësuar herën e parë, listën nuk e kishte pranuar ashtu si të tillë. Në lidhje me këtë çështje, Autoriteti Kontraktues më datë 21/10/2014 iu është drejtuar KRPP-së me shkresë për interpretimin. Autoriteti Kontraktues pasi kishte siguruar interpretim profesional nga KRRPP, ka formuar komision tjetër për ri vlerësimin e Ofertave i cili bazuar në këtë interpretim, listën e punëtorëve për Servisimin e Automjeteve ka pranuar si kriter të përmbushur.

Ajo çka mbetet shqetësuese për Agjencinë Kundër Korrupsion në lidhje me këtë tender, është dallimi në çmimet e ofertave. **P.SH: Për Lot.1, dallimi në çmime mes Operatorëve Ekonomik ofertues mes çmimit më të ulët dhe atij më të lartë është 1143%, çmimi më i lartë është mbi 11 herë më i madh se çmimi më i ultë i ofertuar. Për Lot.2, dallimi në çmime mes Operatorëve Ekonomik ofertues mes çmimit më të ulët dhe atij më të lartë është 349.27%, çmimi më i lartë është thujse 3 herë e gjysmë më i madh se çmimi më i ultë i ofertuar. Për Lot.3, dallimi në çmime mes Operatorëve Ekonomik ofertues mes çmimit më të ulët dhe atij më të lartë është 720.39%, çmimi më i lartë është mbi 7 herë më i madh se çmimi më i ultë i ofertuar.**

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !